

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUARA

“S.S.” SH.P.K

Neni 1

Emërtimi dhe ortakët e Shoqërisë

Sot, në Tiranë, në datën **30.08.2023** me vullnetin e lirë Ortakja e Shoqërisë:

Sindi Salku, shtetase shqiptare e datëlindjes 06.04.1998, lindur në Tiranë, Shqipëri e pajisur me numër personal identifikimi J85406051U.

Vendosi: Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë “S.S.” SH.P.K , më poshtë e quajtur si “Shoqëria”.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

Shoqëria do ta ketë selinë e saj në Kullën D, në rrugën “Komuna e Parisit”, pranë kopshtit Botanik Tiranë me sipërfaqe 31 metra, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë.

Neni 3

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë do të jetë **pa afat**.

Neni 4

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga **2.500.000** (dy milion e pesëqind mijë lekë), e cila përfaqëson 100% të kapitalit.

Ortakja e vetme **Sindi Salku zotëron 100% të kapitalit**, e cila përfaqëson një kuotë të vetme me vlerë 2.500.000 lekë, i cili është tërësisht kapital financiar që përbëhet nga kontributi i ortakës së kompanisë.

Ortakja ka të drejtë ta tjetërsojë këtë kapital, të shtojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Secili ortak disponon një kuotë në Shoqëri. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t’ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të



blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë: Zyrë e këmbim valutor. Agjent transferimi parash. Agjensi turistike. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër ekonomik, tregtar, financiar që gjykohet I dobishëm dhe i nevojshëm për realizimin e objektit të shoqërisë, të japi dhe të marrë me qira . Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, shitblerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, hipotekime, financiare dhe kreditimi, si dhe të marri blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit në shoqëri ose duke u themeluar me objekt të njëjtë ose të afërt me qëllim të realizojë objektin e shoqërisë. Shitje orash. Shitje aksesorë. Shitje produkte kozmetike. Shitje telefona celularë..Tregti artikuj te ndryshem. Tregti cigaresh. Makina me qera.

Neni 6

Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakut

Në rast vdekje apo falimenti të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast të refuzimit të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke patur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit si zotëruar i kuotës.



2

Neni 7

Zmadhimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, nese nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi zmadhimin e kapitalit.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Neni 8

Zvogëlimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, mu kuorumin e përcaktuar në nenin 9 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Ortakët epërballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, në përpjetim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asmblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë më shkrim.

Mbledhja e Asmblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për



Komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkurhet procesverbali përkatës.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në baze të nenit 84 të ligjit nr .9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare”. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektornike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9 i këtij Akti themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët më të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 10

Administratori

Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator për një kohëzgjatje prej **5 vjetësh** për periudhën **30.08.2023 deri 30.08.2028**, e cila do të jetë, **Sindi Salku** e datëlindjes **06.04.1998**, lindur në **Tiranë, Shqipëri** dhe me banim në **Tiranë**.

Administratori/t zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.

Asambleja e përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve të Shoqërisë.

Neni 11

Shpërbërja dhe likuidimi

Shoqëria shpërbëhet për arsyet e parashikuara nga ligji dhe me:

- a. Për mbarimin e afatit.
- b. Për pamundësi të funksionimit ose për inaktivitet të vazhduar të asamblesë,
- c. Për reduktimin e kapitalit nën minimumin ligjore.
- d. Me vendim të asamblesë e për arsye të tjera të parashikuara me ligj

Në të gjitha hipotezat e shpërbërjes, asambleja e ortakëve, do të caktojë një ose më shumë likuidatorë duke percaktuar numrin e likujduesve si dhe kriteret në bazë të të cilave do kryhet likuidimi.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 13

Kontrolli Financiar

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo me shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në atë rast kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

Neni 14

Bilanci Vjetor

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 15


Dividentët

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividentëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërise.

Neni 16

Gjuha

5



Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 17

Dispozita përfundimtare

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themeli dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 “Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë tregtare”.

Ortaku

Sindi Salku

Sindi Salku

